



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KUÇOVË

Nr. 3303 Prot.

Kuçovë, më 28/10. 2022

VENDIM

Nr. 63, datë 25/10/2022

**“PËR MIRATIMIN E MARREVESHJES
DHE PJESMARRJEN E BASHKISE KUÇOVE NE SUBJEKTE ME KOMPETENCA
TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME
UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave 302 date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe largimit, trjatimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Marreveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve date 28.09.2022 lidhur ndermjet Bashkise Kuçove dhe MIE dhe Bashkive Berat,Dimal,Poliçan,Skrapar, pasi shqyroi permbatjen dhe kushtet e parashtruara ne marreveshje me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Te miratoje Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve date 28.09.2022 lidhur ndermjet Bashkise Kuçove dhe MIE dhe Bashkive Berat,Dimal,Poliçan,Skrapar.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i Shoqërisë “ Ujësjiellësi Berat-Kuçove ” UK, që në përputhje me kushtet dhe dakordesine e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve date 28.09.2022, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijoje me miratimin në Asambleshë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjiellësi Berat-Kuçove” UK për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimin e plote të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka , për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

Ky vendim u miratua me 19 vota Pro, - vota kundër dhe - vota abstenim.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
MIGENA BULLARI

